



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

### Komisioni i Apelimit

#### Rregullore e Komisionin e Apelimit (KA)

**Bazuar në Rregulloren për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në USH neni 37 pika 6 miratuar me vendimin e Senatit Akademik nr 106, datë 20.02.2020**

#### Neni 1

Komisioni i Apelimit(në vijim KA) shqyrton dhe merr vendim të arsyetur, në të cilin përfshihen dhe mendimet "kundër", për cdo ankim për vendime te marra prej KIZ; në votimet e KA nuk lejohet abstenimi.

#### Neni 2

KA i merr vendimet me shumicë absolute të të gjithë anëtarëve të tij. Vendimet e KA publikohen në mjeshterin e institucionit ku është e vendosur selia e tij si dhe në faqen zyrtare web të USH, jo më vonë se 24 orë pas marrjes së tyre. Vendimet e KA firmosen nga të gjithë anëtarët.

#### Neni 3

Kryetari i KA, thërret mbledhjen e rradhës dhe cakton rendin e ditës, pervec rasteve kur KA ka vendosur ndryshe. Ai bën të ditur datën dhe orën e mbledhjes per te gjithë anëtarët e KA të paktën 24 orë përpëra mbledhjes, e drejton ,mbledhjen dhe diskutimet si dhe zbatimin e ligjit dhe akteve të tjera nënligjore gjatë marrjes së vendimeve.

Cdo ndryshim në datën e kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet cdo anëtar i KA në të njëjtën mënyrë.

#### Neni 4

Sekretari i KA mban procesverbalin e mbledhjeve i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e KA në fund të çdo mbledhje, administron të gjithë dokumentacion për funksionimin e KA. Përgatit shkresat dhe vendimet e KA. Anëtarët e KA kanë të drejtë të kërkojnë një kopje të njehsuar të të gjithë dokumentacionit të KA.

Vendimet e KA firmosen nga të gjithë anëtarët.

### **Neni 5**

Zëvendësimi i kryetarit dhe sekretarit mund të bëhet përkohësisht, përkatësisht nga anëtari më i vjetër dhe nga anëtari me i ri në detyrë.

Në rastet kur anëtarët me te drejtë vote kanë shërbyer si anëtarë për një periudhë të njëjtë kohe, zëvendësimi i përkohshem do të bëhet përkatësisht nga anëtari me i vjetër dhe nga ai më i riu në moshë.

### **Neni 6**

Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje të vecantë kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1 (një) anëtar i KA, duke përcaktuar cështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma anëtarëve të KA.

### **Neni 7**

KA merr vendime vetëm për cështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes ose kur të paktën 3 (tre) anëtarë vendosin për shqyrtimin edhe marrjen e vendimeve për cështje të cilat nuk janë në rendin e ditës.

Mbledhja janë të hapura për subjektet e parashikuara nga rregullorja e zgjedhjeve.

### **Neni 8**

Përvec rrugëve të komunikiit zyrtar KA pranon si komunikim edhe shkresat e skanuara, dërguar nëpërmjet postës elektronike të KA, [ka2024@unishk.edu.al](mailto:ka2024@unishk.edu.al), të cilat më pas do të bashkëshoqërohen me dokumentacionin përkatës.

Selia e KA ndodhet në sallën nr. 402, (katë i katërt, godina e Rektoratit)

### **Neni 9**

Në rast konflikti mbi interpretimin e kësaj rregulloreje, KA bën interpretimin përfundimtar me shumicën absolute të votave të anëtarëve. Kjo rregullore mund të amendohet në cdo rast me propozimin e kryetarit, sekretarit ose të një prej anëtarëve.

### **Neni 10**

Kur konstatohen gabime materiale në një vendim të KA, KA bën ndreqjen e gabimit me anë të një vendimi shtojcë, duke cituar gabimin material të bërë gjatë zbardhjes së vendimit, duke bërë referencën tek burimi i saktë si dhe duke specifikuar se është i njëjtë vendim i marrë mbi të njëjtat dokumenta të inventarizuara në dosje, gjatë kohës së shqyrtimit dhe marrjes së vendimit të KA.

### **Neni 11**

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

